



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1 Prenga për lotet pas humbjes, i kërkon fajet shqiptarëve! Joshua feston me flamur kuqezi, takon me radhë familjen e Kristjanit (VIDEO)
- 2 Kishte një muaj që mburrej se po përgatiste një sulm, kush është 21-vjeçari që mori para turmën me furgon në Paraden e Krenarisë në Berlin
- 3 SHBA ndal sulmet ndaj Iranit, NYT: Trump u fërhoq nga frika se po pakësoheshin raketat Patriot! Garda Revolucionare kërcënon aleatët e Uashingtonit
- 4 Zbulim i rrallë në Parkun Kombëtar të Llogarasë eksplorojë gjejnë zgavrën 70 metra të thellë (FOTOT)
- 5 Furgoni përplas turmën në Paraden e Krenarisë në Berlin, 1 e vdekur, 16 të plagosur! Në kërkim 21-vjeçari me lidhje islamiste (VIDEO)

Kronikë

I kërkuari nga SPAK, Denis Tafili shfaqet në Durrës, godet me qytën e pistoletës një 36-vjeçar dhe largohet! AMP nis hetimet për policin e përfshirë në sherr, ku pati dhe të shtëna

Ndonëse i shpallur në kërkim nga SPAK, Tafili nuk ka patur frikë të përfshihet në konflikt në mes të ditës. Si për ironi, nga të dhënat e para mësohet se Tafili ka ndërhyrë duke i dalë në mbrojtje policit, në konfliktin e këtij të fundit me Gjuzin. Pavarësisht postbloqeve të ngritura nga policia, i kërkuari nga drejtësia nuk është arritur të kapet.



Denis Tafili

Redaksia 24 Korrik, 22:40 | Përditësimi: 25 Korrik, 11:08

Share Post WhatsApp

A A

Një nga personat më të kërkuar nga SPAK, Denis Tafili, pjesë e grupit të Visit të Pojës, është shfaqur sot në Shkallnurr të Durrësit, ku është përfshirë në një konflikt me Edison Gjuzin. Në ngjarje është implikuar dhe një punonjës policie. Mësohet se ka patur dhe të shtëna me armë.

Një njoftim i policisë, shpjegon se konflikti ka nisur për motive të dobta, ku Gjuzi është goditur me sende të forta (qytë pistolette) nga shtetasit Tafili dhe një 27 vjeçar me inicialet G. M. Të dy banues në Shkallnurr, Durrës, të cilët pas ngjarjes janë larguar me automjet. Pavarësisht postbloqeve të ngritura nga policia, dëshja nuk është arritur të kapet.

Policia pranon përfshirjen e punonjësit të saj, inspektorit L. Xh., "i cili është shoqëruar dhe ndaj tij po kryhen veprimet procedurale nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore"

LEXO EDHE: Në kërkim ndërkombëtar për trafik droge, arrestohet 26-vjeçari nga Kavaja! Pritet ekstradimi drejt Italisë (VIDEO)

Ndonëse i shpallur në kërkim nga SPAK, Tafili nuk ka patur frikë të përfshihet në konflikt në mes të ditës. Si për ironi, nga të dhënat e para mësohet se Tafili ka ndërhyrë duke i dalë në mbrojtje policit, në konfliktin e këtij të fundit me Gjuzin.

Në maj të këtij viti Prokuroria e Posaçme mbylli hetimet për grupin e Elvis Doçit, pjesë e të cilit është dhe Tafili. Grupi u godit një vit më parë falë operacionit të përbashkët me autoritetet italiane, "Ura". Ndaj 24 anëtarëve të grupit rëndojnë akuzat për trafik ndërkombëtar kokaine, grup të strukturuar kriminal dhe pastrim parash. gjatë ekzekutimit të këtij operacioni janë sekuestruar edhe 4 milionë euro cash dhe 12 milionë euro pasuri, kryesisht prona.

Në 21 maj të vitit të kaluar, kur u ndërmor edhe operacioni, u vendos sekuestro për miliona euro pasuri, përfshirë 2 kompani ndërtimi, 4 restorante luksoze, 1 agjenci imobiliare, 1 televizion në Vlorë, të dyshuara se ishin financuar nga trafiku ndërkombëtar i drogës. Ndërkohë, në vendin fqinj janë sekuestruar 9 apartamente, 4 kompani, 7 llogari bankare dhe 3 makina.

Njoftimi i policisë:

Më datë 24.07.2026, rreth orës 15:00, Salla Operative e DVP Durrës është njoftuar se, në fshatin Shkallnurr, gjatë një konflikti për motive të dobëta, shtetasi E. Gj, 36 vjeç, është goditur me sende të forta (qytë pistolette) nga shtetasit D. T., 41 vjeç, person i shpallur më parë në kërkim, dhe G. M., 27 vjeç, të dy banues në Shkallnurr, Durrës, të cilët pas ngjarjes janë larguar me automjet.

Gjithashtu, dyshohet se në konflikt ka qenë i përfshirë edhe një punonjës policie, jashtë shërbimit, Inspektor L. Xh., i cili është shoqëruar dhe ndaj tij po kryhen veprimet procedurale nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore (AMP).

Në vendngjarje, grupi hetimor ka gjetur dhe sekuestruar, në cilësinë e provës materiale, një gëzhjojë pistolette. Dyshohet se gjatë konfliktit është qëlluar një herë në ajër me armë zjarri pistoletë.

Ndërkohë, forca të shumta të Policisë kanë rrethuar zonën, kanë ngritur pika kontrolli dhe vijojnë kontrollet intensive për lokalizimin dhe kapjen e autorëve.

Grupi hetimor, nën drejtimin e Prokurorisë, vijon veprimet për sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes dhe dokumentimin ligjor të saj.

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë.

K.M/E.H/Shqiptarja.com

TAG: denis tafili Dures Edison Gjuzi shkallnurr

Komento

Komente

Durraku: 25/07/2026 02:38
Mir ia ka bo drogaxhiut, paska rraf Sonin e Hajriut. Denisi esht cun flori po ky miu haleve do rraf 3 her ne dit.
Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: Epoka e re e kërkesave, mendoni se reagimi i Ramës për protestat është i duhuri? 24 Korrik, 13:38
Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

- Sherri i Denis Tafilit në Durrës/ AMP nis hetimet për efektivin, i sekuestron armën! I dhunuari Gjuzi: Policin e kam parë disa herë më të kërkuarin e SPAK**
Sokol Dema 25 Korrik, 11:19
- Përplasi për vdekje 74-vjeçaren dhe u largua, arrestohet 65-vjeçari në Durrës! Në pranga edhe djali, fshehu dhe riparoi fugonin e përfshirë në aksident (VIDEO)**
24 Korrik, 13:21
- Durrës/ Punimet në rrugën 'Adria', Rama: Ky investim është një tjetër hap drejt përmirësimit të infrastrukturës urbane (VIDEO)**
23 Korrik, 14:11
- Brenda 20 ditësh dyshohet se kreu 7 vjedhje, arrestohet 29-vjeçari në Durrës (VIDEO)**
23 Korrik, 13:47
- Salla në Hamallaj: Rehabilitimi i hidrovorit rrit sigurinë nga përmbytjet dhe mbron bujqësinë**
22 Korrik, 15:04
- Djegia e fushës së mbetjeve në Krujë, shiu shuan flakët, plehrat digjen ende në brendësi! Tym toksik në zonë (VIDEO)**
22 Korrik, 07:59
- Zjarr në vendgrumbullimin e mbetjeve në Krujë, tymi mbulon zonën (VIDEO)**
21 Korrik, 22:51
- VIDEO/ Si vidheshin paratë në postën e Durrësit, ish-shëfja e Financës lëviz paratë me thasë të zinj**
21 Korrik, 15:08
- Sherr për zhurmat, stafi i dhunor në Golem shuan flakët, turistët turq! Në pranga menaxheri dhe një punonjës i plazhit, 2 të tjerë në hetim**
21 Korrik, 11:12
- Tritol në shtëpinë e vëllait të Julian Ballës në Shkëmb, dyshime për kërcënim! I përfshirë në organizatën e Çopjave, ish-presidenti i klubit 'Erzeni' ende në kërkim nga SPAK**
21 Korrik, 08:56
- Do bënin kontroll në resort, administratori dhe 4 punonjësit marrin peng inspektorët e Tatimeve! Arrestohen nga policia (EMRAT)**
19 Korrik, 11:58
- Zbulohet bazë me armë e municion luftarak në Durrës, arrestohet 20-vjeçari! Furnizonte grupet kriminale (VIDEO)**
19 Korrik, 10:03

Lajmi i fundit
Për herë të parë në një spital publik, 'Memoriali' i Fierit kryen me sukses një ndërhyrje të avancuar në zemër
26 Korrik, 10:34

×

Sh

.COM

Lajmi i fundit



Për herë të parë në një spital publik, 'Memoriali' i Fierit kryen me sukses një ndërhyrje të avancuar në zemër

26 Korrik, 10:34